



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

Nr. _____ më _____

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr.110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Vendimi për caktimin e Komisionit për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave për adoptimin e qenve endacak, në përmbushjen e kushteve sipas kontratës.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, anëtarë të Komisionit janë:
 1. Vjosa Kollani, Drejtorja e Shërbimeve Publike;
 2. Shkëlqim Mustafa, Drejtorja e Shërbimeve Publike;
 3. Donat Gashi, Drejtorja e Shërbimeve Publike.

Detyrë e Komisionit të cekur si në pikën 2 të këtij Vendimi, gjatë vizitave në teren për kushtet, mbarëvajtjen dhe mirëqenien e qenve të adaptuar, është të jep vërejtje dhe ndërmerr masa sipas kushteve të përcaktuara me kontratë, për subvencionim sipas Vendimit nr. 01-422/01-134273/23 i dt. 29.06.2023, ndaj personave fizik dhe juridik, procesit i të gjithë procesit së adoptimit të qenve endacak dhe subvencionimit të personave fizik dhe juridik, bazuar në Vendimin për subvencionimin e personave fizik dhe juridik, të cilët kanë në përkujdesje dhe mbajtje një (1), apo më shumë qenë.

3. Për kryerjen e detyrave të cekura si në pikën 3 të këtij Vendimi, Komisioni i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet

- Anëtareve,
- Qendrës për Komunikim me Qytetarë,
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

